

# KOMUNA - MITROVICË



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës

Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica



## KONTRATË –FURNIZIM

### TITULLI I KONTRATËS

Përshkrimi i Kontratës: Furnizim me Fletushka ,Pano,Postera per aktivitete te ndryshme per DKRS.

NUMRI I PROKURIMIT: 642-19- 7235 -1-3-6

NUMRI I BRENDSHEM: 642/19/048/136

AUTORITETI KONTRAKTUES: KOMUNA E MITROVICËS

OPERATORI EKONOMIK: N.T."Agimi-De",Sheshi Mentor Tolaj,51000, DEÇAN

DATA E NËSHKRIMIT: 29/10/2019

KONTRATË: Furnizim me Fletushka ,Pano,Postera per aktivitete te ndryshme per DKRS.

Nr i prokur: 642-19- 7235 -1-3-6 dhe Nr i brend: 642/19/048/136

## PJESA B: KONTRATA – FURNIZIM

**KOMUNA- MITROVICË**, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë;  
dhe

**N.T. "Agimi- De", Sheshi Mentor Tolaj, 51000, DEÇAN**

, (ne vazhdim "Kontraktori"), me nr Biznesi: **70102346** me nr Fiskal **600050603** dhe nr i tel **045 688 499** ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publikesi vijon: **Furnizim me Fletushka ,Pano,Postera per aktivitete te ndryshme per DKRS.**

- si në vijim:

**Neni 1 Lënda: Furnizim me Fletushka ,Pano,Postera per aktivitete te ndryshme per DKRS.**

me numër identifikues.

Nr i Prokurimit: **642-19-7235-1-3-6**

Nr i brendshëm: **642/19/048/136**

**1.1 Lënda e kontratës do të jetë [FURNIZIMI ], nga punëkryesi i punimeve si në vijim:**

**1.1 Lënda e kontratës do të jetë:Largimi I kaldasë Furnizim me Fletushka ,Pano,Postera per aktivitete te ndryshme per DKRS. sipas DT dhe Përshkrimit te qmimeve..**

<b>Furnizim me Fletushka ,Pano,Postera per aktivitete te ndryshme per DKRS</b>		<b>2.115,00 €</b>

**1.2 Kontrata hynë në fuqi: me 29/10/2019 dhe sipas nevojës DKRS do te porostë materialet e Kontratës ne afat deri më 28/10/2020.**

**1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 2 ditë nga data e marrjes së urdhëreses.**

**Furnizim me Fletushka ,Pano,Postera per aktivitete te ndryshme per DKRS 1.4 Vendi i [kryerjes së FURNIZIMIT] është sipas listës te cilën e përpilon DKRS-ja në Komunën e Mitrovicës.**

**1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP<sup>1</sup> (Detyra e Dërguar e Paguar).**

<sup>1</sup> DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

**KONTRATË: Furnizim me Fletushka ,Pano,Postera per aktivitete te ndryshme per DKRS.**

**Nr i prokur: 642-19- 7235 -1-3-6 dhe Nr i brend: 642/19/048/136**

## Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridikacioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

## Neni 3 Çmimi

3.1 Cmimi total i kontratës do të jetë: [2.115,00 €-(DY mijë e njëqindë e pesëmbdhjetë euro)]

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vërtma pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtronet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtronen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

## Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj sipas furnizimeve të kryera të nënshkruara nga zyrtari pranues dhe Menaxheri i Kontratës ose shumën totale te pagesës ose sipas porosive te kryera nga O.E. për DKRS-në.

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë]

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

## Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

## Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i [furnizimeve] duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në DT dhe Përshkrimin e qmiveve..

## Neni 7 Garancioni

**KONTRATË: Furnizim me Fletushka ,Pano,Postera per aktivitete te ndryshme per DKRS.**

Nr i prokur: 642-19- 7235 -1-3-6 dhe Nr i brend: 642/19/048/136

## **7.1 Garancioni do të jetë sipas specifikave te kërkaura me DT dhe Njoftimin për kontratë**

### **Neni 8 Vonesat në ekzekutim**

**8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [te kryej ndonjë ose te gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [punëve] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.**

### **Neni 9 Inspektimi dhe testimi**

**9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.**

### **Neni 10 Nën-kontraktimi**

**10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktajojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.**

### **Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues**

**11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikuji kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res-judikata; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e res judicata për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmon ton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.**

### **Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik**

**12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimeshit nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsy që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.**

**KONTRATË: Furnizim me Fletushka ,Pano,Postera per aktivitete te ndryshme per DKRS.**

**Nr i prokur: 642-19- 7235 -1-3-6 dhe Nr i brend: 642/19/048/136**

### Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrakte dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [specifiko gjykatën kompetente] në pajtim me ligjin e Kosovës.

### Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhen [Shqip] [Serbisht] [Anglisht]<sup>2</sup> në tri origjinalë, dy origjinalë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Autoritetin Kontraktues: Komuna-Mitrovicë	
Emri:	Haxhimet FERATI
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	29/10/2019
Vula:	

Për Kontraktorin: N.T. "Agimi- De", Sheshi Mentor Tolaj, 51000, DEÇAN	
Emri:	Hajrije SELMANAJ
Pozita:	MENAXHER
Nënshkrimi:	
Data:	29/10/2019
Vula:	

<sup>2</sup> Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

**KONTRATË: Furnizim me Fletushka ,Pano,Postera per aktivitete te ndryshme per DKRS.**

Nr i prokur: 642-19- 7235 -1-3-6 dhe Nr i brend: 642/19/048/136